



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A U.K. VLORE
Lagjia "Kushtrimi" Rruga "Arkobaleno"

Shtojca 14

Autoriteti Kontraktor SH.A UJESJELLES KANALIZIME VLORE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

03.10.2018

Për: Operatorin Ekonomik "**Fat Group**" sh.p.k me nr. Nipti L43428401V

Procedura e prokurimit: "**Blerje matesa uji**"

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-70464-05-22-2018**

Fondi limit: **16.910.000 (gjashte mbedhjete milion e nenteqind e dhjete mije) leke pa TVSH**

Burimi i Financimit: Te ardhurat e Sh.A Ujesjelles Kanalizime Vlore

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Blerje matesa uji**"

Kohëzgjatja e kontratës: Brenda **2** muajve nga data e nënshkrimit te kontratës .

Zhvilluar ne: dt.27.06.2018 ora 10:00. Vendi: www.app.gov.al.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, sipas raportit përfundimtar te KVO-se, miratuar nga Titullari i AK, ne tender kane marre pjese 7 operatore ekonomik me ofertat përkatëse si me poshtë :

1. "**A.M.U**" sh.p.k me nr.nipti **K14229210F** 12.366.400 (dymbedhjetemiilon e treqind e gjashtedhjetete e gjashtemije e katerqind) leke pa tvsh
2. "**Viptis**" sh.p.k me nr.nipti **L02103503S** 13.523.288 (trembedhjetemilione e peseqindenjezet e tremije e dyqindtetedhjetete e tete) leke pa tvsh

3. **“Hidro Mentori” me nr.nipti L11703004N** 14.366.510 (katërmbedhjetemilion e treqind e gjashtedhjetë e gjashtë e pesëqind e dhjetë) leke pa tvsh
4. **“NOVAMAT” sh.p.k me nr.nipti K81615002O** 14.600.250 (katërmbedhjetemilion e gjashtëqindmijë e dyqind e pesëdhjetë) leke pa tvsh
5. **“Comfort” sh.p.k me nr.nipti J61901194M** 15.977.000 (pesëmbëdhjetemilion e nentëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) leke pa tvsh
6. **“Fat Group” sh.p.k me nr.nipti L43428401V** 16.695.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e pesë mijë) leke pa tvsh
7. **“ W-Center” shpk me nr.nipti K63029402A** nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike

Pas mbarimit të vlerësimit të ofertave është arritur në këtë përfundim:

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1 “A.M.U” sh.p.k me nr.nipti K14229210F

Operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka mundur dot të vërtetoj:

-Në dokumentin me emër “Certifikata Aprovimi për përdorim ujë të pijshëm itecon” në faqen nr.2 nuk ka asnjë të dhënë mbi tipin e matësit që është certifikuar për ujë të pijshëm .

Rrjedhimisht nuk vërtetohet se matësi ultrasonic ka certifikatë të ujit të pijshëm.Nuk janë paraqitur manualët e matësive të përdorimit, në dokumentin “Katalog + Specifika + Manual_Instalim” në faqen 11 dhe 12 janë paraqitur disa foto të paqarta mbi montimin e matësit dhe jo manual përdorimi, Për më tepër që këto foto nuk janë për të gjithë matësat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Nuk janë paraqitur Certifikata MID për të gjithë matësat e kërkuar nga autoriteti kontraktor

-në dokumentin e paraqitur me emrin “Katalog + Specifika + Manual_Instalim” në faqen 4 ,Q1 i matësit Ultran Sonic të ofruar është 40 litra për orë ndërkohë që është kërkuar të jete i barabart ose më i vogël se 3 litra në orë bazuar në specifikimet teknikë në DST faqe 31

-jetëgjatësia e baterisë së matësit ultrasonic të paraqitur nga OE si mostër është 10 vjet ndërkohë që në specifikimet teknikë në DST është kërkuar minimumi 15 vjet me biteri për përdorim opsionin e transmetimit të të dhënave me vlerë sipas protokolleve EN 13757-4, OMS ose ekuivalente më të mëdha dhe minimum 11 vjet në rastin kur transmeton të dhënat me radhe.

-Në dokumentin e paraqitur me emrin “Katalog + Specifika + Manual_Instalim” në faqen 7 ka paraqitur katalog për matësin TK-3C ndërkohë që si mostër ka paraqitur një matës modeli TK-5C . Modeli TK-5C i paraqitur si mostër nuk është 1” Sic është kërkuar nga Ak por nga vërtetimi i KVO-Se rezulton në përmasat 1 ½, pra nuk është paraqitur sipas specifikimeve teknikë të kërkuara në DST.

2. “Viptis” sh.p.k me nr.nipti L02103503S

Operatori Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka mundur dot të vërtetoj :

-Mostra e paraqitur si bllokues saraqineske por bllokues për bukëtonat e matësit të ujit.Pra nuk ka paraqitur mostër për bllokues saraqineske në mostrat e dorëzuara pranë Autoritetit

Kontraktor ditën dhe datën e hapjes se tyre.

-Nuk ka paraqitur certifikate higjiene për matësin e ujit 1 e $\frac{1}{4}$ te kompanisë sensus

-Nuk ka paraqitur katalog, Autorizim dhe certifikate ISO 9001 për produktin bllokues saraçineske.

3. “Hidro Mentori” me nr.nipti L11703004N

Operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka mundur dot të vërtetojë:

-Pjesa më e madhe e dokumentave teknik janë përkthime të pa noterizuar nga gjuhët e huaja dhe për pasoje këto dokumenta janë të pavlefshëm. Në këtë mënyrë Ak-ja nuk mund të marrë në konsideratë asnjë dokument i cili nuk ka vlerë materiale pasi është përkthyer. Kjo është theksuar edhe në DST që dokumentat duhet të jenë origjinal ose fotokopje të noterizuara. Nuk ka paraqitur asnjë mostër të produkteve që ofron ditën dhe datën e dorëzimit të mostrave pranë autoritetit kontraktor në kundërshtim me kriteret e veçanta për kualifikim.

4. “NOVAMAT” sh.p.k me nr.nipti K81615002O

Operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka mundur dot të vërtetojë:

-Nuk ka paraqitur pothuajse asnjë mostër për matësat dhe vulat ditën dhe datën e dorëzimit të mostrave pranë autoritetit kontraktor, bllokuesit të debitoreve i paraqitur nga OE nuk janë sipas specifikimeve teknike.

-Me përjashtim të autorizimit të prodhuesit për matësat e ujit, certifikatat e tij si dhe certifikata MID, të gjithë dokumentat e tjerë nuk janë të përkthyer dhe të noterizuara.

-Nuk ka autorizim prodhuesi dhe katalog dhe certifikate ISO 9001 prodhuesi për vulat dhe bllokuesit.

-Matesa e ujit të paraqitur nuk im plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST

-Nuk ka paraqitur certifikate higjiene për matësat.

5. “Comfort” sh.p.k me nr.nipti J61901194M

Operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka mundur dot të vërtetojë:

-Nuk janë paraqitur manuale përdorimi për të gjithë matësat

-Kataloget për vulat janë të papërkthyer në noteri, vulat nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST.

-Bllokuesi i ofruar nuk është në përputhje me specifikimet teknike që gjenden në DST.

- Nuk janë paraqitur autorizime prodhuesi për të gjithë produktet e kërkuara nga autoriteti Kontraktor

-Nuk janë paraqitur të gjithë mostrat e kërkuara ditën dhe datën e dorëzimit të mostrave pranë AK sipas kriterëve të veçanta për kualifikim që gjenden në DST. janë paraqitur mostra vetëm për matësat e ujit $\frac{1}{2}$ dhe $\frac{3}{4}$ ndërkohë që kërkojnë mostrat për matesa uji 1” dhe 2”, mates uji ultra sonic DN-32

-Nuk ka paraqitur certifikate për ujë të pijshëm për matësat e ofruara.

6. “W-Center” shpk me nr.nipti K63029402A

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë oferte ekonomike si dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar si dhe kapacitetin teknik të kërkuar për këtë procedurë.

Eshtë kualifikuar Operatori ekonomik i poshteshenuar:

“Fat Group” sh.p.k me nr.nipti L43428401V

Operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi është paraqitur në tender me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit. Duke qenë se ky operator ekonomik i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka proceduar me kualifikimin e operatorit ekonomik **“Fat Group”**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **“Fat Group” sh.p.k** me nr.nipti L43428401V se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 16.695.000 [gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë]/ leke pa tvsh pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor Sh.A Ujesjelles Kanlizime Vlore Lagja “Kushtrimi” Rr. Arkobaleno sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Se bashku me sigurimin e kontratës duhet të sillni brenda 5 (pese) diteve nga dita e marrjes/publikimit të njoftimit, të gjithë dokumentacionin e paraqitur në tender (original ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Dokumentacioni i listuar me shkrim dhe numer faqesh, duhet të jetë i futur në një zarf të mbyllur dhe i vulosur me vulën e operatorit/subjektit. Zarf i dokumentacionit të tenderit duhet të paraqitet brenda afatit të mesipër, në sekretarinë e SH.A UK Vlore për tu protokolluar.

Nëse dokumentacioni i tenderit, pas verifikimit rezulton i rregullt, atëherë do të procedohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës, nga përfaqësuesit e të dy palëve.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.07.2018 në faqen zyrtare të APP

Ankesa: ka ose jo ___PO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 17.07.2018

* * *

Dorian Xhelili

Titullar i Autoritetit Kontraktor